



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Primjena / Prodato Received / Delivury | 20.09.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKAMSHOR | 5530/2022 | | 1/1 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.765/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2270/2021, të datës 16.08.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr 652/2019 të datës 23.10.2019 të parashtruar nga ankuesja ne adresë kundër organit të punësimit-Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.652/2019 e datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Njoftimi për kandidatin e suksesshëm me numër protokolli 746/19-01 i datës 24.09.2019 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 16.08.2019, me datë 21.08.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Asistent/e Administrativ" në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë në kuadër të Agjencisë për Regjistrim Civil, në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit. Ministria e Punëve të Brendshme pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, më datë 24.09.2019 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm, në bazë të cilit njoftim ankuesja nuk ishte kandidate e suksesshme.

Zyra e Personelit e Ministrisë së Punëve të Brendshme përmes e-mailit ka njoftuar të gjithë kandidatët që kanë qenë pjesë e procesit të rekrutimit cilët eventualisht janë të pa kënaqur duhet të bëjnë ankesë në KPMSHCK për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik.

Ankuesja, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.10.2019 ka parashtruar ankesë kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm për pozitën "Asistent/e Administrativ" në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 4996/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 29.10.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit me datë 01.11.2019 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokolli 5140/2019 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 10.12.2019 me numër protokolli 5722/2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 23.07.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.3117/19, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 24.08.2021, sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.12.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 23.10.2019.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 17.09.2021 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, më datë 16.08.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2270/2021, i cili aktgjykim është pranuar në Këshill me datë 23.08.2022 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 24.08.2021 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritior ka administruar këto prova:
Ankesën me numër protokolli 4996/2019 të datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Adresa e banimit e ankueses e protokolluar me numër 5177/2022 i datës 06.09.2022; Aktgjykimin A.nr.2270/2021 i datës 16.08.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 23.08.2022 me numër protokolli 4884/2022; Fletëkthesë e datës 20.09.2021; Fletëkthesë e datës 23.09.2021; Njoftim me numër protokolli 4682/21 i datës 17.09.2021; Njoftim me numër protokolli 4681/21 i datës 17.09.2021; Aktgjykimin A.nr.3117/19 i datës 23.07.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 24.08.2021 me numër protokolli 4346/2021; Fletëkthesë e datës 11.12.2019; Njoftim me numër protokolli 5722/2019 i datës 10.12.2019; Fletëkthesë e datës 30.10.2019; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 29.10.2019; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 5140 e datës 01.11.2019; Diplomë e K.R. me numër protokolli 1796 e datës 16.06.2004; Aktvendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i K.R. i datës 08.12.2009; Vërtetim i K.R. i datës 03.12.2010; Certifikatë e K.R. e datës 13.12.2005; Letërnjoftim i K.R.; Vërtetim për pranimin e aplikacionit me numër 2172/19 i datës 03.09.2019; Konkurs për plotësimin e vendeve të punës i datës 21.08.2019; Autorizimi i Administratës Publike i datës 16.08.2019; Konkursi në Gazetën Bota Sot i datës 21.08.2019; Vendim me numër 613 për themelimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil i datës 06.09.2019; Formulari MAP-SHCK-05 Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Formulari MAP-SHCK-07a Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Regjistri i aplikacioneve të listës së gjerë; Lista e ngushtë e aplikantëve për testin me shkrim i datës 16.09.2019; E-mail nga Zyra e Personelit në MPB i datës 09.12.2019; E-mail nga Zyra e Personelit në MPB i datës 09.12.2019; E-mail nga Zyra e Personelit në MPB i datës 11.09.2019; Lista e ngushtë e aplikantëve për intervistë me gojë i datës 20.09.2019; Deklaratë e R.L. për mosekzistimin e konfliktit të interesave të komisionit i datës 10.09.2019; Deklaratë e XH.P. për mosekzistimin e konfliktit të interesave të komisionit i datës 10.09.2019; Deklaratë e M.K. për mosekzistimin e konfliktit të interesave të komisionit i datës 10.09.2019; Deklaratë e S.B. për mosekzistimin e konfliktit të interesave të komisionit i datës 10.09.2019; Deklaratë e S.S. për mosekzistimin e konfliktit të interesave të komisionit i datës 10.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 26.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 26.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Formulari MAP-SHCK-08 Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 20.09.2019; Përmbledhja e

vlerësimeve individuale i datës 24.09.2019; Formulari MAP-SHCK-11 Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 24.09.2019; Raport Përmbledhës i datës 24.09.2019; Njoftim me numër 746/19-01 për kandidatin e suksesshëm i datës 24.09.2019; Testi me shkrim i kandidatës E. B. i datës 16.09.2019; Kërkesa për punësim i kandidatës E.B.; Certifikatë e E.B. e datës 17.06.2011; Certifikatë e E.B. e datës 31.04.2010; Certifikatë e datës 15.02.2011; Vërtetim i E.B. i datës 25.07.2019; Ofertë për Internship (Praktik Pune) i datës 28.05.2018; Ofertë për Internship (Praktik Pune) i datës 16.03.2018; Marrëveshje për angazhim në masën aktive të tregut të punës e E.B. i datës 01.07.2019; Vërtetim i E.B. i datës 29.08.2019; Letërnjoftim i E.B.; ID e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës e E.B.; Patentë shoferi i E.B.; Diplomë e E.B. me numër protokolli 714 i datës 17.05.2016; Kërkesa për punësim i kandidatës K.R. i datës 28.08.2019; Diplomë e K.R. me numër 1796 i datës 16.06.2004; Certifikatë e K.R. i datës 13.12.2005; Vërtetim i K.R. i datës 03.12.2010; Aktvendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e K.R. i datës 08.12.2009; Letërnjoftim i K.R.; Testi me shkrim i kandidatës K.R. i datës 16.09.2019;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja pretendon se kandidatja e zgjedhur për pozitën "Asistent Administrativ" në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë sipas Njoftimit për kandidatin e suksesshëm me numër 746/19-01 të datës 24.09.2019, nuk ka plotësuar kushtet për këtë pozitë sepse e njëjta nuk ka pasur përvojën e punës prej tri (3) vite ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Kolegji nga shqyrtimi i Autorizimit të DASHC si dhe Konkursit të datës 21.08.2019 ka konstatuar se kriteret themelore për pozitën "Asistent Administrativ" në Qendrën për Pajisje me Dokumenteve në Prishtinë, kanë qenë: *Arsimim i mesëm, trajnime përkatëse; Së paku tri (3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative; Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës në fushën e regjistrimit civil dhe të pajisjes me dokumente; Shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë aplikacione të programeve informata tek të tjerët; Shkathtësi kompjuterike World dhe Excel.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses se kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet për këtë pozitë, është i pa qëndruar sepse në bazë të dëshmive të bashkëngjitura në lëndë nga organi i punësimit gjegjësisht MPB, Kolegji bazuar në dosjen e aplikimit të ankueses ka konstatuar se kandidatja e zgjedhur posedon: Vërtetim të datës 25.07.2019 me të cilin dëshmohet se ka punuar në pozitën Asistente Administrative në kompaninë Taxman L.L.C. në Prishtinë në periudhat kohore nga data 20.05.2016 deri me 16.03.2018, dhe 19.12.2018 deri me datë 28.06.2019 si dhe nga data 19.06.2018 deri me 18.12.2018 dhe 19.03.2018 deri me datë 18.06.2018, e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune në programin për zhvillim të UNDP-OKB, ndërsa sipas marrëveshjes për angazhim në masën aktive të tregut të punës si praktikante nga data 01.07.2019 deri me datë 31.12.2019. Gjithashtu Kolegji ka shqyrtuar pretendimin e ankueses lidhur me konfliktin e interesit e cila pretendon se në këtë pozitë është pranuar një familjare e Menagjeres së Burimeve Njerëzore, Por Kolegji nuk është lëshuar në trajtimin e pretendimit të ankueses, sepse të gjithë anëtarët e Komisionit kanë nënshkruar deklaratë që nuk janë në konflikt të interesit lidhur me këtë pozitë të shpallur nga MPB.

Bazuar në këto fakte rezulton se kandidatja e përzgjedhur ka plotësuar kushtet e konkursit për pozitën e "Asistent Administrativ" në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë dhe se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 11 paragrafi 1 me të cilin përcaktohet se: *Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve si dhe nenin 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: arsimimin dhe kualifikimin dhe përvoja e punës", e mbi këtë bazë Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i pa bazuar.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Njoftimit për kandidatin e suksesshëm me numër 746/19-01 të datës 24.09.2019 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike të çështjes në procedurë.

Bazuar në përmbledhjen e vlerësimeve individuale si dhe Raportin e përmbledhjes të datës 24.09.2019 kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me gjithsej 87% pikë, ndërsa ankuesja është renditur e katërta me gjithsej 71% pikë, e mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civilë ku është përcaktuar se: *në Shërbimin Civilë emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin me të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe gojë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me zhvillimin e procedurës rekrutuese si dhe pas trajtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën "Asistent Administrativ" në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanshinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR. 765/2021

Çlirim ZEKA


Procesmbajtës

Eshref SHABANI


Kryetar Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- Arkivot te KPMSHCK-se

